

PRAKTIKA PROFESIONALE NË FAKULTETIN E EKONOMISË, NJË ELEMENT I RËNDËSISHËM QË LIDH STUDENTËT ME TREGUN E PUNËS

*Mirela Cini¹, Matia Çuçllari², Frederik Çuçllari³
Aida Gabeta⁴, Landi Gushi⁵*

¹Fakulteti i Ekonomisë, Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri
mirelacini@yahoo.com

²Faculty of Economics and Business, KU Leuven, Brussels, Belgium,
matiacucllari@gmail.com

³Fakulteti i Ekonomisë, Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri
fcucllari@gmail.com

⁴Fakulteti i Ekonomisë, Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri
aidagabeta72@gmail.com

⁵Fakulteti i Ekonomisë, Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, Shqipëri
lgushi@yahoo.com

Abstrakt

Praktikat profesionale ofrohen si një komponent akademik i të mësuarit nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si një mjet efikas që u jep studentëve mundësinë e kombinimit të mësimit në auditor me përvojat e botës reale. Është një sfidë e vazhdueshme për Institucionet e Arsimit të Lartë që të hartojnë kurrikulat e tyre në mënyrë të tillë që të vendosin një ekuilibër midis njohurive teorike në auditor dhe aftësive praktike gjithnjë në ndryshim, si dhe aftësive "të buta" që studentët të jenë realisht në gjendje të zbatojnë atë që ata mësojnë. Ky punim synon të nxjerrë në pah përfitimet dhe sfidat me të cilat përballen studentët gjatë praktikës së tyre. Të dhënat e kufizuara në lidhje me tiparet specifike të projektimit të praktikave dhe ndoshta më e rëndësishmja, përvojat e studentëve, e bëjnë sfidues vlerësimin dhe përmirësimin e përvojës së praktikës. Pavarësisht nga interesi në rritje, ende dihet pak se si dhe çfarë mësojnë studentët gjatë praktikës, dhe sesi mësimi i tyre çon në përmirësime të aftësive dhe kompetencave që i bëjnë të mundur këto përfitime. Duke eksploruar pyetje të tilla, ne besojmë se Universiteti mund të ndihmojë që studentët të jenë të përgatitur mirë për praktikat e tyre dhe tregun e punës, dhe që mundësitë të jenë gjithëpërfshirëse dhe të lehtësojnë suksesin e studentëve.

Fjalët kyçe: *praktika profesionale; aftësi; kompetenca; studentët; punëdhënësit.*

PROFESSIONAL INTERNSHIPS AT THE FACULTY OF ECONOMICS, AN IMPORTANT COMPONENT THAT CONNECTS STUDENTS WITH THE LABOUR MARKET

Abstract

Professional internships are offered as an academic component of learning by Higher Education Institutions, an effective tool that gives students the opportunity to combine classroom learning with real-world experiences. It is an ongoing challenge for Higher Education Institutions to design their curricula in such a way as to strike a balance between theoretical knowledge and the ever-changing practical skills, as well as “soft” skills so that students are able to concretely apply what they are learning. This paper aims to highlight the advantages and challenges that students face during their internship. Limited data regarding the specific features of internship design and perhaps most importantly, students’ experiences, make it challenging to evaluate and improve the internship experience. Despite growing interest, little is still known about how and what students learn during these internships, and how their learning leads to improvements in the skills and competencies that make the aforementioned advantages possible. By exploring such questions, we believe that the University can help ensure that students are well-prepared for their internships and the labour market, and that given opportunities are inclusive and facilitate student success.

Keywords: *professional internship; skills; competencies; students; employers.*

Hyrje

Praktikat profesionale ofrohen si një komponent akademik i të mësuarit nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si një mjet efikas që u jep studentëve mundësinë e kombinimit të mësimit në auditor me përvojat e botës reale. Praktikat ofrojnë ekspozim dhe përvojë të rëndësishme në vendin e punës përpara punësimit. Të nxënit në auditor shërben për të arritur zotërimin e përgjithshëm të lëndëve të programit të studimit, ndërsa mësimi jashtë auditorit përforcon dhe demonstron zbatimin e njohurive teorike dhe pedagogjike, aftësive intelektuale dhe praktike (Kuh, 2000). Pra teoria reflekton praktikën dhe praktika pasqyron teorinë, duke ofruar një lidhje kuptimplote mes asaj që mësohet në auditor dhe asaj që praktikohet në arenën profesionale (Toncar & Cudmore, 2000). Lidhja midis tyre është

thelbësore për përgatitjen e studentëve për arritjen e qëllimeve arsimore dhe të karrierës, si dhe për punësimin e tyre (Getzel et al., 2000).

Nga ana tjetër, praktikat profesionale u krijojnë organizateve mundësinë 'për të testuar' në avancë punonjësit potencialë (Coffey & Strawser, 2018). Pra, programet e praktikës janë të dobishme për studentët, Universitetin dhe punëdhënësit. Përparësitë e kryerjes së një praktike janë pranuar nga të gjitha palët në fushën e arsimit, përfshirë studentët, Universitetin, si dhe punëdhënësit (Vélez & Giner, 2015). Praktikrat e suksesshme janë produkt i partneriteteve të forta midis punëdhënësve, universiteteve dhe studentëve (Koning et al., 2019).

Pavarësisht nga këto, dihet pak se si dhe çfarë mësojnë studentët gjatë praktikës, dhe sesi mësimi i tyre çon në përmirësime të aftësive dhe kompetencave që i bëjnë të mundura këto përfitime. Ky punim i bazuar në gjetjet e projektit "*Vlera e praktikës si element i rëndësishëm që lidh studentët me tregun e punës*", financuar nga të ardhurat e Universitetit "Fan S. Noli" 2024, synon të adresojë këtë boshllëk (Cini et al., 2024). Duke eksploruar pyetje të tilla, ne besojmë se Universiteti mund të ndihmojë që studentët të jenë të përgatitur mirë për praktikrat e tyre dhe tregun e punës, dhe që mundësitë të jenë gjithëpërfshirëse dhe të lehtësojë suksesin e studentëve.

Metodologjia

Ky studim eksploron qëllimet, vlerat dhe pritshmëritë që studentët kanë në lidhje me praktikën e tyre, si dhe mënyrën se si ata perceptohen në vendin e punës nga organizatat pritëse. Në studim u përdorën elementë të kërkimor sasior dhe cilësor. Në studim u përdor analiza përshkruese dhe statistikore për të vlerësuar ndikimin e programeve të praktikës në rritjen profesionale dhe personale të studentëve. Në kërkim u përdor teknika e pyetësorit të strukturuar, të përbërë nga disa pjesë (profili i të anketuarve, vlerësimi i informacionit në lidhje me rritjen profesionale dhe personale dhe përmirësimin e aftësive). Çdo variabël i pyetësorit u vlerësua duke përdorur shkallën Likert me 5 pikë (1 aspak dakord; 5 plotësisht dakord). Të dhënat u programuan dhe u analizuan duke përdorur *software R*. Instrumentat e kërkimit u zhvilluan dhe u testuan në

terren me metoda të përziera në gjashtë programe të studimit Bachelor të Fakultetit të Ekonomisë (referuar në vijim FE), të Universitetit "Fan S. Noli" (referuar në vijim UNIKO), të cilët kryhen praktikat si pjesë të programit të tyre të studimit, gjatë vitit 2024.

Rezultatet e studimit

Gjatë vitit 2024 praktika u zhvillua në gjashtë programe studimi të Ciklit të Parë (Bachelor), në FE. Numri i studentëve që zhvilluan praktikën gjatë vitit 2024 përbënte 89.91 përqind të numrit të studentëve të vitit të tretë bachelor. Referuar të dhënave marrë nga sektori i TIK-ut, UNIKO, lidhur me numrin e studentëve që zhvilluan praktikën gjatë vitit 2024, programi i studimi bachelor "Financë-Kontabilitet" ka numrin më të madh të studentëve që zhvilluan praktikën gjatë vitit 2024, 43.92 përqind të numrit total të studentëve që zhvilluan praktikën këtë vit nga FE. Të gjithë studentët e përfshirë në studim kanë kryer praktikën me një kohëzgjatje 2 javë. Afërsisht 90 përqind e tyre paraqitnin si anë negative kohëzgjatjen e kufizuar të praktikës dhe kohën e pamjaftueshme të realizimit të aktiviteteve të planifikuara.

Ne shqyrtoam tre tregues kryesorë të cilësisë së praktikës: programi i praktikës, niveli i aktiviteteve të punës në të cilat marrin pjesë praktikantët, dhe mentorimi dhe mbështetja e mbikëqyrësit. Ekzistojnë gjithashtu dy rezultate kryesore të praktikës përmes të cilave ne shqyrtojmë cilësinë. Ata janë shkalla në të cilën praktikantët zhvillojnë aftësitë dhe fitojnë besim ose qartësi rreth qëllimeve të karrierës së tyre.

Programet e praktikës _ Të dhënat e studimit tregojnë se të gjithë studentët që morën pjesë në praktika u pajisën me program praktike të shkruar, të stukturuar me qëllime dhe aktivitete mësimore, duke treguar se studentëve u ofrohet mbështetje e rëndësishme e strukturuar mësimore. Por nga ana tjetër, 35.51 përqind e studentëve që morën pjesë në praktika mendonin se ajo nuk ishte e stukturuar sikundër ishin pritshmëritë e tyre.

Natyra e detyrave të kryera gjatë praktikës _ Një aspekt kyç i një përvojë praktike është natyra e detyrave që praktikantët kryejnë në vendin e punës. Ndërsa një student praktikant teorikisht mund të përfitojë nga një pozicion ku ai kryen detyra me aftësi të ulëta nën

mbikëqyrje ose thjesht "nën hijen" e një punonjësi me përvojë, teoricienët e të mësuarit sugjerojnë që fillestarët përfitojnë më shumë nga prezantimi gradual, nga detyra me aftësi të ulëta në ato me aftësi të larta, nën mbikëqyrjen e një mentori (Lave & Wenger, 1991).

Ne pyetëm studentët për natyrën e detyrave të kryera gjatë praktikës dhe të dhënat tregojnë se pjesa më e madhe e studentëve (85.98 përqind) raportojnë se ishin thjesht vëzhgues, duke e bërë kështu praktikën një përvojë me pak vlerë mësimore dhe zhvillimore.

Cilësia e mbikëqyrjes dhe mentorimit – Cilësia e mbikëqyrjes organizative dhe mentorimit akademik është kritike për një praktikë të suksesshme, dhe studentët e vlerësuan mbështetjen e mbikëqyrësve organizative më pak se mentorimi i tyre. Të kesh një mbikëqyrës efektiv dhe mbështetës është një nga elementët më të rëndësishëm të një përvoje të suksesshme praktike. Mbështetja e mbikëqyrësit i referohet mbështetjes aktive të mbikëqyrësve në vendin e punës. Një seksion me pesë pika (Figura1) të tilla si, "Mbikëqyrësi im më dha detyra që më dhanë mundësinë për të zhvilluar dhe forcuar aftësi të reja" dhe për studentët në këto gjashtë programe studimi të FE, rezultati mesatar i mbikëqyrjes organizative ishte 2.96 (në një shkallë nga 1-5).




Figura 1. Rezultati mesatar për shkallën e mbikëqyrjes organizative

Aspekti tjetër është mentorimi i praktikës, i cili i referohet mbështetjes aktive të udhëheqësit të praktikës për zhvillimin e karrierës së praktikantëve dhe kënaqësinë në vendin e punës. Në këtë seksion u përfshinë pesë pika (Figura 2) të tilla si, "Udhëheqësi im ishte i disponueshëm dhe i aksesueshëm kur kisha pyetje ose shqetësime". Mesatarisht, niveli i mbështetjes së perceptuar nga studentët në këto gjashtë programe të FE ishte 4.25 (në një shkallë nga 1-5).




Figura 2. Rezultati mesatar për shkallën e mentorimit

Vlerësimi i kënaqësisë së studentëve _ Një nga pyetjet kryesore në lidhje me një përvojë praktike është nëse studentët e vlerësonin atë si një përvojë të kënaqshme ose jo. Megjithatë të qenit i kënaqur jo domosdoshmërisht lidhet me treguesit e cilësisë së praktikës të tillë si, hartimi i programit ose sjelljet mbikëqyrëse, gjithsesi mund të konsiderohet si një tregues i përgjithshëm i vlerësimit të studentëve për përvojën e tyre. Në fillim të praktikës, studentet femra raportuan besim më të ulët për të pasur një përvojë praktike të kënaqshme, krahasuar me studentët meshkujt. Në fund të praktikës, besimi i studenteve femra kishte kaluar atë të studentëve meshkuj. Në fund të praktikës, afërsisht 67.28 përqind e studentëve raportuan se ishin shumë të kënaqur me përvojat e tyre të praktikës, por 1 në 3 studentë

raportuan më pak se përvoja të kënaqshme. Rezultatet janë paraqitur në Figurën 3.

Rezultatet në skajin e poshtëm të spektrit të kënaqësisë mund të tregojnë se kërkohet punë me mentorët akademikë, organizatat pritëse dhe/ose studentët për të përmirësuar programet, ndërsa rezultatet më të larta mund të sugjerojnë që FE ka një listë të mirë ofertash praktike në dispozicion të studentëve të tij.




Figura 3. Vlerësimet e kënaqësisë

Vlera e zhvillimit akademik – Praktikant dhe përvojat e të nxënies të bazuara në punë duhet të ofrojnë aftësi të kërkuara, të transferueshme dhe njohuri disiplinore të lidhura me formimin akademik të studentëve. Një shkallë e vlerave zhvillimore e përbërë nga pesë pika (Figura 4) që përfshinin deklaratat e tilla si, "Kjo praktikë më ndihmoi të identifikoja boshllëqet në njohuritë e mia të marra në auditor", u përdor për të matur shkallën në të cilën të anketuarit e perceptojnë përvojën e tyre të praktikës si të vlefshme për zhvillimin e tyre akademik. Mesatarisht, niveli i vlerës së zhvillimit akademik i raportuar nga studentët në gjashtë programe studimi Bachelor ishte 3.72 (në një shkallë nga 1-5).

Rezultati mesatar 3.72




Figura 4. Rezultati mesatar për shkallën e vlerës së zhvillimit akademik

Vlerësimi më i ulët rezultoi në atë se sa praktika i jepte mundësi studentit për të zbatuar atë që ka mësuar në programin e tij të studimit, në situata reale. Ky vlerësim sugjeron që kurrikulat akademike duhet domosdoshmërisht të rifreskohen vazhdimisht për të pasqyruar dhe reflektuar në kohë zhvillimet praktike që ndodhin në botën reale.

Vlera e zhvillimit të karrierës _ Një tjetër rezultat i rëndësishëm i një përvoje praktike është shkalla në të cilën ajo rrit qëllimet dhe mundësitë e karrierës së studentëve. Edhe nëse praktika është vetëm për një periudhë të shkurtër, ajo mund të pajisë një student me një sërë aftësish të rëndësishme, të krijojë lidhje të vlefshme për karrierën e tij të ardhshme. Për këtë në pyetësor u zhvillua një seksion me pesë pika që përfshinin deklaratat e tilla si, "Kjo praktikë më ndihmoi të qartësoja qëllimet e mia të karrierës". Mesatarisht, niveli i vlerës së zhvillimit të karrierës (Figura 5) i raportuar nga studentët në gjashtë programe studimi Bachelor të FE ishte 3.71 (në një shkallë nga 1-5).

Rezultati mesatar 3.71




Figura 5. Rezultati mesatar për shkallën e vlerës së zhvillimit të karrierës

Pika me vlerësimin më të ulët që ka të bëjë me atë se sa mirë praktika e ndihmoi studentin të identifikonte punëdhënësit e ardhshëm, sugjerojnë që disa elementë të procesit të kërkimit të punës mund të përmirësohen në të ardhmen.

Zhvillimi i aftësive gjatë praktikave _ Treguesi përfundimtar i cilësisë së praktikës në këtë raport i përket çështjes kritike të zhvillimit të aftësive. Një nga argumentet kryesore pas praktikave është se përvoja u ofron studentëve mundësi për të përvetësuar dhe përmirësuar aftësitë teknike, por edhe kompetenca që quhen ndryshe "të buta" ose "aftësi të shekullit 21". Në studimin tonë u përfshinë pyetje bazë mbi shkallën në të cilën praktika ofronte mundësi për të zhvilluar aftësi të tilla si: komunikimi, zgjidhje problemesh, punë në grup, etj. Mesatarisht, niveli i vlerës së zhvillimit të aftësive gjatë praktikës (Figura 6) raportuar nga studentët në gjashtë programe studimi Bachelor të FE ishte 3.76 (në një shkallë nga 1-5).

Rezultati mesatar 3.76




Figura 6. Rezultati mesatar për mundësitë për të zhvilluar aftësitë kryesore

Grafiku në vijim (Figurat 7) ofron një krahasim të rezultateve mesatare të treguesve kryesorë të cilësisë së praktikës profesionale të zhvilluar gjatë vitit 2024 në programet e studimit Bachelor të FE. Rezultati më i ulët paraqitet tek mbikëqyrja organizative ($M=2.96$), ndërsa rezultati më i lartë paraqitet tek mentorimi akademik ($M=4.25$). Rezultatet tregojnë se kërkohet një vëmendje më e madhe, veçanërisht ndaj disa treguesve, për një program praktike me cilësi më të lartë, i cili do të rezultonte në ndikime pozitive në mundësitë e punësimit për të diplomuarit.




Figura 7. Rezultatet mesatare të treguesve kryesorë të cilësisë së praktikës

Kufizimet e studimit

Natyra e studimit dhe zgjedhjet metodologjike të bëra para dhe gjatë studimit, përcaktuan jo vetëm vlefshmërinë e gjetjeve të studimit, por edhe disa nga kufizimet e tij. Këto përfshijnë sa vijon:

- Studimi u shtri në harkun kohor të semestrit të dytë të vitit akademik 2023-2024. Rezultatet do të ishin më të besueshme nëse studimi do të shtrihej në disa vite akademike.
- Gjetjet e studimit u bazuan në informacionet e dhënë nga të anketuarit, të cilat ndonjëherë mund të kenë qenë të njëanshme apo shtrembëruara për arsye të ndryshme. Gjithashtu, pjesëmarrësit mund të mos i kenë kuptuar pyetjet në të njëjtën mënyrë. Këto, në një farë mase, mund të ketë çuar në gabime marginale në rezultatet e studimit.
- Studimi u ndërlikua nga fakti se kampioni nuk kishte tipare uniforme në disa aspekte si për shembul, natyra e praktikës, numri i studentëve në një program studimi, etj. Prandaj, lexuesit duhet t'u qasen gjetjeve dhe përfundimeve të studimit me kujdes.
- Madhësitë e mostrës për disa programe studimi ishin të vogla. Për shkak të kësaj, rezultatet për këto grupe duhet të interpretohen me kujdes. Dihet se madhësitë e vogla të kampionit japin rezultate statistikore që janë më pak

përgjithësuese për grupet e tjera (Kerlinger, 1986; McCall, 2001; Rosenthal & Rosnow, 2008).

Përfundime

Praktikat ofrohen si një komponent akademik i të mësuarit nga Institucionet e Arsimit të Lartë, si një mjet efikas që u jep studentëve mundësinë e kombinimit të mësimit në auditor me përvojat praktike në skenarë të botës reale. Pavarësisht dallimeve në praktikat e kryera, të gjitha palët në fushën e arsimit, përfshirë studentët, Universitetin, si dhe punëdhënësit, i vlerësojnë praktikat. Është e zakonshme të gjesh boshllëqe midis asaj që studentët mësojnë në auditor dhe realitetit në terren. Praktikat ndihmojnë në plotësimin e këtyre boshllëqeve dhe kontribuojnë në punësimin e studentëve në të ardhmen.

Ndikimi i përgjithshëm i praktikave tek studentët ishte pozitiv. Ata vlerësuan aftësitë që fituan gjatë praktikës së tyre: aftësi të reja, njohuri praktike, aftësi për t'u përshtatur me mjedise të ndryshme pune, aftësi për menaxhimin e kohës, aftësitë e komunikimit dhe marrëdhëniet ndërpersonale. Përmirësimet duhet të përfshijnë: sistemin e krediteve të praktikës, organizimin dhe menaxhimin e programit të praktikës, dhe forcimin e bashkëpunimit me sektorin profesional. Një vëmendje e shtuar ndaj këtyre dimensioneve do të kontribuonte në një program praktike më të mirëorganizuar, më të mirëmenaxhuar, dhe me cilësi më të lartë, i cili përfundimisht do të rezultonte në ndikime pozitive në mundësitë e punësimit për të diplomuarit.

Nga ana tjetër, ne sugjerojmë më shumë kërkime të orientuara për të përcaktuar se në çfarë mase dhe në cilat kushte kombinimet e të mësuarit në auditor dhe në vendin e punë janë më të suksesshme sesa vetëm arsimi terciar, në ofrimin e aftësive dhe njohurive që u nevojiten studentëve për të gjetur punë dhe për t'u angazhuar në karriera të kënaqshme.

Epoka që ne jetojmë është epoka e inovacioneve, zhvillimit dhe zgjerimit teknologjik. Pra, është e nevojshme të rriten aftësi të tilla tek studentët që do t'i ndihmojnë ata të përballen me botën moderne të punës. Për këtë, ekziston nevoja për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, zhvillimin e kurrikulës, duke përfshirë më shumë kërkime dhe duke ofruar trajnime praktike për studentët. Studentët janë e ardhmja e çdo vendi. Është kërkesë e kohës që nëse Shqipëria dëshiron të jetë një vend i zhvilluar, duhet të fokusohet më shumë në

trajnimin praktik të studentëve, në mënyrë që ata të mund të performojnë më mirë në botën reale të progresit.

Referencat

- 1 Cini, M., Çuçllari, F., Gabeta, A., & Gushi, L. (2024). *Vlera e praktikës si element i rëndësishëm që lidh studentët me tregun e punës* (Raport 2024). Universiteti "Fan S. Noli".
- 2 Coffey, L. P., & Strawser, M. G. (2018). Engaging the Millennial Workforce through High-Quality Internships. *Recruitment, Retention, and Engagement of a Millennial Workforce*, 177.
- 3 Getzel, E. E., Briel, L. W., & Kregel, J. (2000). Comprehensive career planning: The VCU career connections program. *Journal of Work*, 14, 41–49.
- 4 Kerlinger, F. (1986). *Foundations of behavioral research* (3rd ed.). New York: Holt, Rinehart, Winston.
- 5 Konig, L. S., Mikrut, M., & Hocenski, M. (2019). Employers' views on partnerships in higher education. *Trabalho apresentado na XV Interdisciplinary Management Research, Opatija, Croácia*.
- 6 Kuh, G. D. (2000). Understanding campus environments. In *The handbook of student affairs administration*. San Francisco, CA: Jossey-Bass Publishers.
- 7 Lave, R. & Wenger, E. (1991) *Situated Learning. Legitimate peripheral participation*. Cambridge: University of Cambridge Press.
- 8 McCall, R. B. (2001). *Fundamental statistics for behavioral sciences* (8th ed.). Wadsworth Pub.Co.
- 9 Resnick, L. B. (1987). Constructing knowledge in school. In L. S. Liben (Ed.), *Development and learning: Conflict or congruence?* (pp. 19–50). Lawrence Erlbaum Associates, Inc.
- 10 Rosenthal, R., & Rosnow, R. L. (2008). *Essentials of Behavioral Research: Methods and Data Analysis* (3rd ed.). New York: McGraw-Hill.
- 11 Toncar, M., & Cudmore, B. (2000). The overseas internship experience. *Journal of Marketing Education*, 22(1), 54-63. DOI: 10.1177/0273475300221007
- 12 Universiteti "Fan S. Noli". (2024). "Plani Strategjik i Universiteti 'Fan S. Noli' Korçë 2022-2027"
https://unkorce.edu.al/archive/programi_transparences/KUADRI%20LIGJOR%20RREGULLATOR/strategji/strategji3.pdf
- 13 Universiteti "Fan S. Noli". (2024). *Programe studimi*
https://unkorce.edu.al/archive/unkorce_programet/index_shqip.php

- 14 Vélez, G. S., & Giner, G. R. (2015). Effects of business internships on students, employers, and higher education institutions: A systematic review. *Journal of Employment Counseling*, 52(3), 121–130.